



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**“HASAN PRISHTINA”**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 360

Datë: 10/02/2020

Bazuar në nenin 6, paragrafi 1.8, nenin 13, paragrafi 1.14, nenin 48, paragrafi 1.9 dhe nenin 216 paragrafi 3 i Statutit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Senati i Universitetit në mbledhjen e mbajtur më 07. 02. 2020, miraton:

## **RREGULLORE**

**për proceset dhe procedurat e përgatitjes për riakreditimin institucional dhe të programeve studimore në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

1. Kjo rregullore përcakton formën, proceset dhe procedurat për përgatitjen e akreditimit dhe ri akreditimit institucional dhe të programeve studimore të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” (UP).
2. Rregullorja po ashtu përcakton afatet kohore që duhet të respektohen nga strukturat e UP, të bashkërenduara konform afateve ligjore të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ, nr. 15/2018, për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, dhe rregulloreve tjera të UP.
3. Rregullorja synon orientimin dhe lehtësimin e punës së strukturave përgjegjëse të Universitetit rreth përgatitjes së procesit të riakreditimit institucional dhe të programeve studimore në Universitetin “Hasan Prishtina”.

### **Neni 2**

#### **Procedurat e përgatitjes për riakreditim institucional**

1. Përgatitja për procesin e riakreditimit në Universitetin e Prishtinës realizohet përmes një procesi hap pas hapi, siç është paraqitur në skemën e këtij procesi në Aneksin I, të kësaj rregulloreje, si dhe si është përshkruar në nenin 2 të kësaj rregulloreje.
2. Procesi i përgatitjes për riakreditim institucional bazohet në Planin e UP të akreditimit institucional.
3. Së paku 10 muaj para afatit të aplikimit për riakreditim institucional Zyra për Zhvillim Akademik (ZZhA), përmes Prorektorit për Cilësi, inicion procesin e përgatitjes për aplikim për riakreditim institucional, përmes një kërkesë parashtruar Rektorit të UP.

4. Me aprovimin e kërkesës Rektori me një vendim formon një Grup Punues për draftimin e Raportit të Vetë-Vlerësimit (RVV) për riakreditim institucional.
5. Grupi Punues përbëhet nga:
  - a. Prorektori për Cilësi;
  - b. Drejtori i ZZhA;
  - c. Një përfaqësues nga Komisioni për Cilësi;
  - d. Një Koordinator për Zhvillim Akademik (nga NjA);
  - e. Dy personel akademik;
  - f. Një përfaqësues i studentëve;
6. Grupi Punues, brenda pesë muaj nga data e emërimit (respektivisht deri më 30 maj) drafton RVV-në për akreditim institucional, duke u konsultuar me të gjitha strukturat dhe mekanizmat relevant të Universitetit, të cilin e ndan për konsultim me Kolegjin e Dekanëve. Zyra për Zhvillim Akademik (ZZhA) ofron përditësimet e fundit të standardeve të cilësisë, të promovuara nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA).
7. Kolegji i Dekanëve brenda dy javëve (më se largu deri më 15 qershor) komenton draftin e RVV dhe i dërgon komentet dhe rekomandimet tek Grupi Punues.
8. Deri më 30 qershor Grupi Punues inkorporon komentet dhe rekomandimet e mundshme nga Kolegji i Dekanëve, dhe përmes ZZhA-së e përcjell draftin e RVV-ve tek Komisioni për Cilësi i UP-së.
9. Komisioni për Cilësi shqyrton draft RVV bazuar në listë kontrollin për RVV dhe aspektet tjerat të cilësisë, dhe deri më 15 korrik e përcjell tek ZZhA-ja.
10. ZZhA deri më 30 shtator procedon draftin final të RVV-së për përkthim në gjuhën angleze tek një Grup Teknik për përkthim, i cili emërohet nga Menaxhmenti i UP.
11. ZZhA përgatitë aplikimin për akreditim institucional (Fletë aplikimin dhe Faqen e Parë) dhe e dorëzon atë në AKA, jo më vonë se më 30 tetor të vitit gjegjës. Dokumentacioni i tillë nënshkruhet nga Rektori.
12. AKA e shqyrton kërkesën dhe e pranon apo refuzon atë. Në rastin e refuzimit, ZZhA, bashkë me strukturat gjegjëse në UP, e shqyrton mundësinë e përmirësimit të aplikimit, apo adreson çështjet që kanë qar në refuzim të aplikimit.
13. ZZhA e dërgon RVV-në (dhe dokumentacionin relevant përcjellës) në AKA më së voni 30 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së AKA-së për këtë qëllim.
14. Gjatë fazës kur AKA shqyrton aplikimin e universitetit bashkë me RVV-në, Komisioni për Cilësi dhe ZZhA, përgatiten për vizitën e ekspertëve, duke organizuar edhe një simulim provë (Mock) me zyrtarët e UP-së, përgjegjës për të marrë pjesë në takimet dhe procesin e vizitës vlerësuese nga AKA. Përgatitja e tillë realizohet rreth një javë para vizitës vlerësuese të AKA-së.
15. ZZhA në aranzhim me Menaxhmentin e UP-së dhe AKA-së ndihmon në organizimin e vizitës së AKA dhe ekspertëve të jashtëm për vlerësim.

16. Pas vizitës së ekspertëve, ZZhA pranon draft raportin e vlerësimit nga AKA dhe e procedon në strukturat e brendshme (Komisioni për Cilësi, Menaxhmenti, etj) për shqyrtim dhe komentim.
17. ZZhA dërgon tek AKA draft raportin e vlerësimit së bashku me komentet dhe informatat shtesë, sipas kërkesës dhe afatit kohor të përcaktuar nga AKA.
4. Pas pranimit të vendimit final nga AKA, ZZhA dhe Komisioni për Cilësi përgatisin Planin e Përbushjes së Rekomandimeve dhe e dërgojnë tek AKA. Njëkohësisht, ZZhA dhe Komisioni për Cilësi drejtojnë dhe monitorojnë zbatimin e Planit sipas dinamikës dhe veprimeve të dakorduara në Plan.

### **Neni 3**

#### **Procedurat e përgatitjes për riakreditim të programeve studimore në nivel të Universitetit**

1. Përgatitja për riakreditimin e programeve studimore në UP realizohet përmes një procesi hap pas hapi, siç është paraqitur në skemën e këtij procesi në Aneksin II të kësaj rregulloreje, si dhe si është përshkruar në nenin 3 në këtë rregullore.
2. Procesi i përgatitjes për riakreditim bazohet në Planin e UP për riakreditimin e programeve studimore.
3. Së paku 12 muaj para afatit të aplikimit për riakreditim institucional ZZhA njofton Njësitë Akadematike (NjA) rreth paraqitjes së kërkesave të tyre për riakreditim të programeve studimore. ZZhA njëkohësisht dërgon te NjA kornizën e RVV-të përditësuar me standardet e fundit për akreditim të promovuara nga AKA.
4. NjA formon Grupin Punues për zhvillim të RVV-së për programet studimore në aplikim.
5. RVV-ja e draftuar nga NjA duhet të aprovohet në Këshillin e Fakultetit përkatës, para se të procedohet tutje tek ZZhA.
6. NjA dërgon draft RVV të aprovuara tek ZZhA jo më vonë se 15 maj të vitit gjegjës.
7. Në rastin e aplikimit për riakreditim, NjA dërgon tek ZZhA RVV-në e kompletuar më së voni më 11 maj. Programet në riakreditim nuk kalojnë për shqyrtim në Komisionin për Studime e as për aprovim në Senat. Në rast se nuk ka komente, ZZhA e dërgon RVV për riakreditim direkt në AKA.
8. ZZhA kontrollon RVV-në e pranuar nga NjA, bazuar në listë kontrollin e hartuar sipas standardeve të fundit të promovuara nga AKA.
9. Pas kontrollit fillestar, ZZhA procedon programet për vlerësim të mëtejshëm te Komisioni për Cilësi, dhe Komisioni për Studime.
10. Bazë për kontrollimin e përbushjes së standardeve të zhvillimit të RVV për programet studimore merren së paku:
  - a. Listë kontrolli për standardet e sigurimit të cilësisë (SC);
  - b. Rregullorja për SC;
  - c. Udhëzuesi për zhvillim të syllabuseve;

- d. Dokumente tjera relevante;
11. ZZhA më së voni me 15 korrik kthen RVV-të tek NjA me komentet (nëse ka) e vlerësimit nga mekanizmat e cekur në pikat 6 dhe 7 të këtij neni.
  12. NjA brenda 50 ditëve kthen tek ZZhA programet e finalizuara, duke inkorporuar komentet nga procesi i vlerësimit paraparak.
  13. ZZhA / Zyra për Çështje Akademike (ZÇA) brenda javës së parë të shtatorit procedon në Senat kërkesën e NjA për aprovim.
  14. Më së largu deri më 30 shtator Senati aprovon ose refuzon kërkesat dhe programet në aplikim për riakreditim.
  15. Njëkohësisht, deri më 30 shtator NjA përmes një Grup Teknik për përkthim, i cili emërohet nga menaxhmenti i fakultetit, bën përkthimin e RVV në gjuhën angleze, dhe e dërgon në ZZhA.
  16. ZZhA deri më 30 tetor më së largu përgatitë aplikimet (Fletë aplikimet dhe Faqet e Para) për programet e miratuara në Senat dhe i dërgon ato në AKA, bashkë me listat e personelit akademik bartës të programeve studimore në aplikim, sipas standardit të kërkuar nga AKA.
  17. Me rastin e hapjes së platformës E-akreditimi nga AKA, NjA sigurohet që personeli respektiv akademik regjistrohet dhe deklarohet për vitin pasues akademik.
  18. AKA i shqyrton kërkesat dhe i pranon apo refuzon ato. Në rastin e refuzimit, ZZhA, bashkë me NjA, i shqyrtojnë mundësinë e përmirësimit të aplikimit, apo adresojnë çështjet që kanë qar në refuzim të aplikimit.
  19. ZZhA e dërgon në AKA, Raportin e Vetë-Vlerësimit të programeve studimore të aprovuara në Senat, më së voni 30 ditë kalendrike nga data e pranimit të kërkesës së AKA-së për këtë qëllim.
  20. Në ndërkohë që AKA shqyrton RVV-të e dorëzuara për vlerësim, ZZhA, NjA dhe Koordinatorin për Zhvillim Akademik (KzhA) brenda NjA, përgatiten për vizitën e ekspertëve, duke organizuar edhe një simulim provë (Mock) me personelin e NjA përgjegjës për të marrë pjesë në takimet dhe procesin e vizitës vlerësuese nga AKA.
  21. ZZhA në aranzhim me Menaxhmentin e UP-së, NjA-së, KZhA-së dhe AKA-së ndihmon në organizimin e vizitës së AKA-së dhe ekspertëve të jashtëm për vlerësim.
  22. Pas vizitës së ekspertëve, ZZhA pranon draft raportin e vlerësimit nga AKA-ja dhe e procedon tek NjA-të dhe strukturat tjera sipas nevojës (Komisioni për Cilësi, Menaxhmenti, etj) për shqyrtim dhe komentim.
  23. ZZhA dhe NjA-të, brenda afatit të caktuar nga AKA-ja, dërgon tek AKA-ja draft raportin e vlerësimit së bashku me komentet dhe informatat shtesë (sipas kërkesës nga AKA-ja).
  24. Pas pranimit të vendimit final nga AKA-ja, ZZhA dhe NjA-të përgatisin Planin e Përbushjes së Rekomandimeve dhe e dërgojnë tek AKA-ja brenda afatit kohor të përcaktuar nga kjo e fundit. Njëkohësisht, NjA drejton zbatimin e Planit sipas dinamikës dhe veprimeve të paraqitura në Plan, ndërsa ZZhA bën monitorimin e zbatimit të planeve.

## Neni 4

### **Procedurat e përgatitjes për riakreditim të programeve studimore në nivel të Njësive Akademike**

1. Procedurat për përgatitjen e RVV për (ri)akreditim të programeve studimore brenda NjA zhvillohen sipas procesit të paraqitur në këtë nen dhe skemës së procesit të paraqitur në Shtojcën III të kësaj rregulloreje.
2. Procesi i përgatitjes së RVV për (ri)akreditim të programeve studimore të NjA fillon së paku 12 muaj nga data e aplikimit për (ri)akreditim në AKA.
3. Koordinator i Zhvillimit Akademik (KZhA) i NjA, brenda 5 ditë pune nga pranimi i njoftimit nga ZZhA-ja, informon strukturat e brendshme të NjA-së për iniciimin e procesit për riakreditim të programeve studimore.
4. Departamenti apo Katedra brenda NjA-së në konsultim me Komisionin për Studime dhe KZhA-në zhvillojnë apo rishikojnë programet studimore për akreditim apo riakreditim në formatin e RVV-së, të cilën e dërgojnë tek ZZhA-ja më së voni deri më 30 prill të vitit gjegjës për aplikim.
5. NjA gjatë zhvillimit apo rishikimit të programeve ka këto përgjegjësi:
  - a. Merr parasysh inkorporimin e Standardeve për SC të dërguara nga ZZhA;
  - b. Siguron që programet e reja dhe ato në rishikim janë të bazuara në planifikimin financiar/buxhetor;
  - c. Përditëson personelin dhe dosjet e personelit;
  - d. Inkorporon të dhëna dhe informata tjera konform rregulloreve në fuqi;
6. Prodekani për Mësim me bartësit e programeve deri më 10 maj procedojnë te Këshilli i Fakultetit për aprovim programet studimore të zhvilluara apo rishikuara.
7. Me aprovimin nga Këshilli i Fakultetit, deri më 15 maj KZhA-ja dërgon tek ZZhA-ja programet e aprovuara, në formatin e RVV-së.
8. Në rastin e aplikimit për riakreditim, NjA dërgon tek ZZhA-ja, RVV-në e kompletuar më së voni deri më 11 maj. Programet në riakreditim nuk kalojnë për shqyrtim në Komisionin për Studime e as për aprovim në Senat. Në rast se nuk ka komente, ZZhA-ja e dërgon RVV-në për riakreditim direkt në AKA.
9. Deri më 15 korrik KZhA-ja pranon nga ZZhA-ja komentet dhe rekomandimet e mundshme, dhe i përcjell ato te Departamenti apo Katedra përkatëse.
10. Departamenti apo Katedra integron komentet dhe rekomandimet në RVV sipas komenteve të ZZhA-së, Komisionit për Cilësi, dhe Komisionit për Studime.
11. Prodekani për Mësim me bartësit e programeve procedojnë tek Këshilli i Fakultetit për aprovim programet studimore të zhvilluara apo rishikuara me integrimin e komenteve dhe rekomandimeve të ZZhA-së, Komisionit për Cilësi, dhe Komisionit për Studime.

12. Me aprovimin nga Këshilli i Fakultetit, KZhA dërgon tek ZZhA-ja programet e aprovuara, në formatin e RVV-së, më së largu 50 ditë kalendarike nga data e pranimin të komenteve nga ZZhA-ja.
13. Njëkohësisht, deri më 30 shtator, NjA bën përkthimin e RVV-së në gjuhën angleze, si dhe përgatitë aplikimin (Faqen e parë dhe fletë aplikimet të cilat nënshkruhen nga Dekani i NjA-së) dhe e dërgon tek ZZhA-ja.
14. Me rastin e hapjes së platformës E-akreditimi nga AKA-ja, NjA sigurohet që personeli përkatës akademik regjistrohet dhe deklarohet për vitin pasues akademik.

## **Neni 5**

### **Dispozitat kalimtare**

1. Rregullorja plotësohet dhe ndryshohet duke iu përshtatur afateve ligjore të përcaktuar në legjislacionin në fuqi rreth procedurave të riakreditimit institucional dhe programeve studimore, si dhe duke u përshtatur me nevojat e brendshme organizative të UP për këtë proces.
2. ZZhA apo strukturat tjera përgjegjëse të UP-së iniciojnë procedurën për ndryshimin dhe plotësimin e kësaj rregullore.

## **Neni 6**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Senatit të UP-së.



Prof. Dr. Marjan Dema


Kryesues i Senatit, Rektor

# Shtojca 1 –Skema e procesit për përgatitjen e (ri)akreditimit institucional

## Procesi për përgatitjen e (ri)akreditimit institucional

(Përgjegjës: Rektori / Prorektori për Cilësi / Komisioni për Cilësi / ZZhA / Dekanët)

Procesi i akreditimit institucional nga fillimi deri në vendim të akreditimit zgjatë afërsisht 18-22 muaj




Procesi nga aplikimi deri tek vendimi final zgjatë afërsisht 9-12 muaj

**Grupi Punues** përbëhet nga:  
 a. Prorektori për Cilësi;  
 b. Drejtori i ZZhA;  
 c. Një përfaqësues nga Komisioni për Cilësi;  
 d. Një Kordinator për Cilësi;  
 e. 2 stafë akademik;  
 f. Një përfaqësues i studentëve;


**AKA** - Agjencioni i Kosovës për Akreditim  
**RVV** - Raporti i Vet-Vlerësimit  
**UP** - Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"  
**ZZhA** - Zyra për Zhvillim Akademik

## Shtojca 2 – Skema e procesit për përgatitjen e (ri)akreditimit të programeve studimore në nivel të Universitetit





### Shtojca 3 – Skema e procesit për përgatitjen e (ri)akreditimit të programeve studimore brenda Njësisë Akadematike



- AKA** - Agjencioni i Kosovës për Akreditim
- RVV** - Raporti i Vet-Vlerësimit
- UP** - Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"
- NjA** - Njësia Akadematike
- ZZhA** - Zyra për Zhvillim Akademik
- KZhA** - Kordinatori për Zhvillim Akademik
- SC** - Sigurimi i Cilësisë